



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/124

Datë: 10.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit për zbatimin e udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave.
2. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave duhet të mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2013 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/124

Datë: 10.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 27 të Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Përcaktohen dhe kategorizohen Pikat e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror të Republikës së Kosovës.

2. Pikat e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, janë:

- 2.1. Vermica;
- 2.2. Orqusha;
- 2.3. Shishtavec;
- 2.4. Gllaboqica/Borje;
- 2.5. Qafa e Prushit; dhe
- 2.6. Qafa e Morinës.

3. Pika e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, është:

- 3.1. Kulla

4. Pikat e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, janë:

- 4.1. Bërnjaku;
- 4.2. Jarinjë;
- 4.3. Merdare;
- 4.4. Mutivoda;

4.5. Dheu i Bardhë dhe

4.6. Muqibaba.

5. Pikat e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, janë:

5.1. Hani i Elezit dhe

5.2. Glloboqica.

6. Pika e Kalimit Kufitar të trafikut Hekurudhor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, është:

6.1. Hani i Elezit.

7. Pika e Kalimit Kufitar të trafikut Hekurudhor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, është:

7.1. Leshaku;

8. Pika e Kalimit Kufitar të trafikut ajror në Republikën e Kosovës, është:

8.1. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari".

9. Sipas rëndësisë dhe veprimtarisë, pikat e kalimit kufitar të trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror kategorizohen në kategoritë A, B dhe C.

10. Pikat e Kalimit Kufitar të kategorisë A janë :

10.1. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari";

10.2. Vermica;

10.3. Merdare;

10.4. Jarinjë;

10.5. Hani i Elezit;

10.6. Dheu i Bardhë;

10.7. Kulla dhe

10.8. Stanqiqi;

Pikat e Kalimit Kufitar të kategorisë A janë të hapura 24 orë në ditë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave. Në këto pika të kalimit kufitar, duhet të jenë prezent vazhdimisht zyrtarët e Policisë së Kosovës, të Doganës së Kosovës dhe ata të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

11. Pikat e Kalimit Kufitar të kategorisë B, janë :

11.1. Mutivoda;

11.2. Muqibaba;

11.3. Glloboqica;

11.4. Qafa e Prushit;

11.5. Qafa e Morinës; dhe

11.6. Bernjaku;

Pikat e Kalimit Kufitar të kategorisë B janë të hapura 24 orë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave. Në këto Pika të kalimit kufitar, zyrtarët Policisë së Kosovës duhet të jenë prezent 24 orë në ditë, ndërsa zyrtarët e Doganave të Kosovës dhe ata të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, duhet të jenë prezent gjatë intervaleve kohore të përcaktuara me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje.

12. Pikat e Kalimit Kufitar të kategorisë C, janë :

- 12.1. Krusheva;
- 12.2. Orqusha; dhe
- 12.3. Gllloboqica/Borje.

Pikat e Kalimit Kufitar të kategorisë C, janë të përkohshme dhe janë të hapura për intervale të caktuara kohore. Këto pika të kalimit kufitar shërbejnë vetëm për qarkullim të personave dhe hapen në pajtim me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje.

13. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinës, dhe institucionet e tjera për zbatimin e këtij vendimi.

14. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/124

Datë: 10.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr. 4/L-159 për Zonat Ekonomike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Kombëtar për Zona Ekonomike në këtë përbërje:

1.1. Valdrin Lluka - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,	Kryesues;
1.2. Nashide Bajrami - Ministria e Financave,	anëtare;
1.3. Agim Kukaj - Ministria e Zhvillimit Ekonomik,	anëtar;
1.4. Ekrem Gjokaj - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	anëtar;
1.5. Besim Kamberaj - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,	anëtar;
1.6. Naim Ismajli - Asociacioni i Komunave të Kosovës,	anëtar;
1.7. Arian Zeka - Oda Ekonomike Amerikane,	anëtar;
1.8. Muharrem Osmani - Aleanca Kosovare e Biznesit,	anëtar;
1.9. Lumnije Hashani - Oda Ekonomike e Kosovës,	anëtare.

2. Këshilli detyrat e tij i kryen në pajtim me nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/124

Datë: 10.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrugës Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Vushtri, Zonat Kadastrale, Babimoc, Milloshevë Komuna Obiliq dhe Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm, Gracë, Pestovë, Novosellë e Maxhunit, Velika Rekë dhe Dumnicë e Poshtme të Komunës së Vushtrrisë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria e Financave e cila mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Infrastrukturës.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/124

Datë: 10.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në Zonat Kadastrale Balincë, Llazicë, Mleqan dhe Kijevë, Komuna Malishevë e të cilat preken nga ndërtimi i rrugës Nacionale N9 Fushë Kosovë-Arllat-Gjurgjicë, Segmenti Gjurgjicë-Kijevë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria e Financave e cila mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Infrastrukturës.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë